BASHKIA
DIMAL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA DIMAL**
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT, INVESTIMEVE, KONTROLLIT TË PROJEKTEVE, E SHËRBIMEVE PUBLIKE, STREHIMIT DHE TRANSPORTIT

Nr______Prot                                        Urë Vajgurore më _____ /_____       / 2024

# R E L A C I O N

**Përshkrim i detajuar i gjendjes së banimit të komuniteteve të varfëra të pafavorizuara.**

Në Bashkinë Dimal jeton një komunitet i konsiderueshëm i varfër si në qytet ashtu edhe në fshatrat e saj. Në territorin tonë kemi komunitetin Rom të përqendruar në fshatin Pashalli dhe Agim. Për këtë komunitet dhe për shtresat në nevojë bashkia po punon për përfundimin e planit 5 vjecar të strehimit., të cilin besojmë që do e përfundojmë dhe miratojmë brenda muajit prill 2023.
Aktualisht është përfunduar evidentimi i banesave të cilat do jenë pjesë e kësaj thirrje, ka përfunduar komuniteti Rom, i cili do te beje 5% te gjithe grupit te banesave të evidentuara. Janë shume familje te komunitetit rom por kanë mungesë të dokumentit të pronësisë që është një nga kushtet kryesore për tu futur në programin e strehimit..
Si dhe ka përfunduar evidentimi në terren i 21 objekteve me probleme, për të cilat do vazhdohet me plotësim të dokumentacionit tekniko ligjor.
Përsa i përket shtrirjes territoriale banesat që përfshihen në këtë aplikim jane të vendosura në fshatin, Poshnje, Arrez, Vokopolë, Konisbaltw, Skrevan, Bistrovicw, Malas Grope, Cete, Allambres, Slanice, Donofros, Gorican, Kutalli dhe Drenovicë të Bashkise Dimal. Disa prej tyre janë persona me aftësi të kufizuar dhe me ndihmë ekonomike. Disa banesa janë të dëmtuara nga termetet, për të cilat janë kryer procedurat konform legjislacionit në fuqi. Familjet janë tepër të varfëra dhe jetojnë në kushte të mjerueshme banimi e në pamundësi finaciare për të investuar në përmirësimin e kushteve të tyre së jetesës.

Specifikisht po parashtrojmë situatën social ekonomike dhe jetike të çdo familje për të cilat janë hartuar planet dhe projektet e ndërhyrjeve për përforcim apo rindërtim.

1. **Znj.Shahe Tafa, Fshati Kutalli, Njesia Administrative Kutalli.** Kryefamiljare vetmuar e cila jetonte ne kushte te veshtira ekonomike. Femijet e saj ishin larguar jashte shtetit dhe ajo jetonte e vetme nekushte ekstremisht te veshtira. Banesa e saj ishte e ndertuar me plithare dhe jashtw cdo standarti pwr tw jetuar. Shtepia perbente rrezik shembje dhe nene shahe ndihej cdo dite e rrezikuar prej saj. Kerkohen nderhyrje emergjente pasi shtepia ishte e pabanueshme.

2. **Znj.Zaide Dhembo, fshati Bistrovic, Njesia Administrative Ure Vajgurore.** Eshte kryefamiljare e vetmuar dhe jetonte ne kushte shumete veshtira. Burri ikishte vdekur prej vitesh dhe femijet jane larguar. Shtepiae saj ishte methemeguri muratur guri por e pabanueshme per momentin

duke rrezikuar jeten e saj. Muret dhe catia kishin pesuar carje dhe jetesa ne kete shtepi ishte shume e veshtire per tw. Znj. Zaide kishte gjendje guret dhe rreth 800tulla pwr ndertimin e shtepisw. Kwrkohet ndwrhyrje emeregjente pasi shtepia pwrben rrezik shwmbje.

3. **Z.Ramiz Stefano Shimo, nw fshatin Pashalli, Njësia Administrative Ure Vajgurore .** Është familje e komunitetit Rom, e përbërë nga 9 persona kryefamiljari Stefano Shimo , bashkëshortja e tij, tre fëmijët, nusja e djalit dhe tre femije.. Janë në kushte të veshtira ekonomike dhe të papunë. Banesa kerkon cati pasi ishte mellamarine dhe fuste lageshti brenda.

4. **Z.Sabri Shimo, fshati Pashalli, Njësia Administrative Ure Vajgurore .** Eshte familje e perbere prej dy personash, kryefamiljari Sabri Shimo dhe bashkeshortja e tij. Jane familje tekomunitetit Rom, te papune dhe pa ndihme ekonomike. Ishin ne kushte te veshtira ekonomike dhe ne pamundesi per te riparuar vet banesen e tyre. Banesa është me muraturë guri, dhe ka problematik ne zonen e catisw sw saj. Nga bashkia është haruar projekti për rikonstruksionin e catise sw kësaj banese.

5. **Z.Myslym Shehu, fshati Drenovicë, Njësia Administrative Kutalli.** Banesa e tyre ishte totalisht e amortizuar , eshte ndertimivjeter dhe me plitharw. Janw familje e komunitetit te varfer, jetojnw nw kushte tw veshtira ekonomike, 4 pjesar madhor dhe tre fwmijw.Janw familje e komunitetit egjiptjan, ku të ardhurat e tyre të vetme ishin nga bujqësia. Projekti i rikonstruksionit hartuar nga bashkia përfshin ndërtimin e brezit lidhes nën cati, rindertim catie , dyer dritare dhe suvatime.

6. **Z. Riza Kapllani, fshati Slanice, Njësia Administrative Cukalat.** Familje e cila i përket komunitetit të varfër, e përbëre prej 4 personave, dy nw moshw madhore dhe dy femije. . Banesa e tyre kisjte nevoj pwr cati dhe riparime te tavaneve, kishte carje të mureve dhe catisë. Kjo banese eshte me murature guri me balte. Themele mur guri dhe cati druri. Kryefamiljari Riza Kapllani ishte i papune dhe e kishte te mpamundur riparimin e shtepisw.

7. **Znj.Artiol Barjami, fshati Drenovic, Njësia Administrative Kutalli.** Janw familje e varfer, te papune dhe jetojne ne kushtet e veshtira ekonomike. Familja e tyreperbehet nga dy pjestar madhordhe dy femije. Kryefamiljarikish ndertuar shtepine e re deri ne nje pike pore kish te pamundur ta mbyllteate. Shtepia e re kishte nevoj per suvatime instalime dhe pllaka. Neshtepine e vjeterjetonin gjithsej10 persona, prinderit dhe dy vellezermefamiljete tyre. Të ardhuart e vetme janë nga pensioni, që më shumë i shkon për ilacet dhe kujdesin shëndetësor.

8. **Z.Petraq Dyshniku, fshati Vokopol, Njësia Administrative Ure vajgurore . .**Familja përbehet nga tre persona, Z.Petraq bashkeshortja dhe djalii tyre. Të ardhurat janë të pakta vetem nga bujqësia. Banesa është e dëmtuar dhe eshte nevoja per cati dhe tavane pasi catia ka pesuar carje dhe ne kohe me reshje, uji i shiut futet ne shtepi.

9. **Z Elmas Vrapi, fshati Gorican, Njesia Administrative Ure Vajgurore.** Familja perbehet nga dy persona madhor, kryefamiljari Elas Vrapi dhe djali i tij. te cilet janw pjesë e komunitetit shume të varfër. Djali i tij ishte i semure dhe duhej cdo javw te shkonin per dializw ne spital. Shtepia ishte me muraturë guri dhe balte, themele guri dhe mbulim me çati. Ishte nevoj urgjente per riparimete mureve pasikishin pesuar carje, gjithashtu dhe per dyer e pllaka.

10. **Znj.Zybe Hyka ,fshati Kutalli, Njësia Administrative Kutalli.** Kryefamiljare e ve e cila jetonte e vetme., Znj.Fize ishte ne moshw madhore dhe dy djemte e saj ishin larguar jasht shtetit. Pwr te kujdeseshin banoret e zones per cdo nevoj qe mund te kishte. Shtëpia ishte e ndërtuar me themele guri, murature guri dhe mbulim me çati. Shtepia ishte e amortizuar duke rrezikuar shembjen e saj dhe ishte e rrezikshme per jetesen e nenes ne nevoj. Të ardhurat e saj ishin tepakta dhe mepensionin qe merrte paguante ilacet dhe shume pak teprote per ushqime. Gjendja e saj ishte serioze dhe shume e veshtir duke kerkuar nevojen urgjente per nderhyrje. Projekti i baneses se saj eshte hastuar nga nga ana jonw.

11. **Znj, Zonje Hoxha, fshati Drenovic, Njësia Administrative Kutalli**. Jane familje me tre anëtarë, të cilët janë në moshë madhore. Nwna Zonjw Hoxha jetonteme nusen e djalit dhe nipin pasidjaliisajkishte nderruar jete. Ishin ne kushte te veshtira ekonomike dhe te papune. Banesa ishte e ndërtuar me blloqe betoni dhe cati me llamarine.Kushtet e baneses janë të këqijaq.
Bashkia ka hartuar projektin per rindertim catije, suvatime, duer dhe dritare.

12. **Z.Irakli Gushali, fshati Vokopol, Njësia Administrative Ure Vajgurore.** Janë familje e perbere prej dy personash nemosh madhore dhe pensionistw. Tw ardhurat e tyre ishin te pakta, pensioni i tyre nuk mjaftonte per nevojat bazike te jeteses. të pakta. Banesa ka shumë lagështi dhe dëmtime të catisw. Kerkohet ndertimi catise dhe tavaneve.

13. **Z.Haziz Mjelli, fshatin Drenovic,Njësia Administrative Kutalli.** Familja jeton në kushte të vështira ekonomike. Me shumë mund dhe vështirësi kryefamiljari ka arritur te ngrejë një banesë por nuk e ka përfunduar. Kryefamiljari ka probleme shëdetësore gjithashtu ka dhe nji vajze te semure e cila trajtohet me PAK. Bashkia ka përgatitur projektin për perfundimin e banesës. Projekti përfshin ndërtimin e catisë, suvatime, dyer, dritare dhe instalime.

14. **Z.Faslli Rustemi, Fshati Donofrosw, Njësia Administrative Cukalat** Familje e perbere prej tre personash, Faslli Rustemi, bashkeshortja e tij dhe djali. Jetojne ne kushte shumete veshtira ekonomike. Banesa e tyre ishte e ndertuar me plithar dhe jashte cdostandartiper te jetuar. Kishte probleme me muraturen e shtepise. Duhej nderhyrje ne perforcim strukture, brez betoni dhe cati. Kerkohen suvatime instalime si dhe dyer dritare. Jane te papune dhe ne kushte te veshtira ekonomike per ta riparuar vet shtepine.

15. **Z.Shaban Hoxhaj, fshati Bistrovice, Njësia Administrative Urë Vaqjgurore.** Kryefamiljari Z.Shaban jetonte me bashkwshorten e tij dhe të ardhurat e vetme janë vetem nga pensioni. Ishin ne kushte shume tw veshtira ekonomike dhe ne pamundesi pwr ta ndertuar vetw baneswn e tyre.

Banesa kishte lageshti te tepert dhe ka nevoje per suvatim sidhe nje cati te re pasi soleta thuajse kishte rwnw e gjithw. Ishte nevoja per nji brez ngritje dhe strukture perforecuese pasi shtepia ishte e vjeter.

16. **Z.Sulo Vrapi, fshati Drenovice, Njësia Administrative Kutalli.** Familje e pwrbere prej tre personash madhor, te papune dhe ne pamundesi ekonomike pwr te rregulluar vet shtepine. Eshte nevoja per nji cati dhe tavane pasi ne kohe me reshje shiu uji futet brenda.

17. **Z.Armon Kordha, fshati Slanic ,Njësia Administrative Cukalat.** Familjee perbere prej tre personash, Z.Armon, bashkeshortja e tij dhe djali. Jane te papune dhe jetojne ne kushte shumete veshtira ekonomike.Si pasoj e largesisise sw shtepisw e ndodhur ne fshat shumelarg qytetit e ben te veshtir jetese. E vetmjae ardhur e tyre ishte bujqesia. Shtepia ndodhej ne kushte jo te mira, ishte nevoja per cati te re,tavane pasikioshte carje ne mure dhe cati, ishte banes e amortizuar dhe ishte nevoja per strukture perforcuese.

18. **Z. Ilir Hoxhaj, fshati Konisbalte, Njësia Administrative Ure Vajgurore.** Kjo familje përbëhet nga 6 antare, prej tyre 5 persona ne mosh madhore. Jane familje ne pamundesi ekonomike dhe te papune. Kerkohet nevoja per cati dhe tavane pasi lageshtia eshte problemi kryesor. Projekti i hartuar nga bashkia perfshin catin, tavane dhe pllaka.

19. **Z.Adrian Shebeku ,fshati Konisbalte, Njësia Administrative Ure Vajgurore.** Është familje e komunitetit të varfër, e përbërë prej 7 persona, prej tyre 4 persona ne moshw madhore. Janë në kushte të vështira ekonomike dhe të papunë. Banesa është e amortizuar dhe tërmetet e viteve të fundit kanë shkaktuar dëmtime të mëtejshme të cilat kanë nevojë për ndërhyrje në mënyrë që të përmirësohen kushtet e banimit. Projekti i hartuar nga bashkia përfshin përforëcimin e objektit, nderhyrje ne cati, tavane dhe suvatime.

20. **Z.Fejzi Protoduari, fshati Poshnje, Njësia Administrative Poshnje.** Është familjee perbereprej dy personash, Z.Fejsidhe bashkeshortjae tij. Jane persona ne mosh madhore dhe pensioniste, duke e patur keshtu te veshtire riparimet e shtepise. Tw ardhurat e tyre jan tepakta dhe ekane shume te veshtir riparimet e shtepisnga ana e tyre. Banesa ishte e vjeter, memuraturdhe themel guri, kishte carje te mureve dhe catise. Ishte nevoja e nj strukture perforcuese ,cati, suvatime dhe pllaka.
Projekti i hartuar nga bashkia përfshin forcim të themelit, muraturës dhe ndërtim të catisë.

21. **Z.Flamur Hoxha, Fshati Gorican, Njësia Administrative Kutalli**. Familje eperbere prej 4 personash nder tyre 3 perona ne mosh madhore. Shtëpia e tyre ishte e ndërtuar me themele guri, murature guri dhe plithare, mbulim me çati. Ishte banese e vjetere cila kishte nevoje pernderhyrje. Të ardhura nuk mjafojne për të investuar në përmirësimin e kushteve të jetesës. Projekti i rikonstruksionit përfshin rindërtimin e catisë dhe shtresave, strukture perforcuese, riparime suvatimesh, dyer dritare.

22. Z.**Robert Shella, Lagjia "4 Shtatori", Nj Administrative Ure Vajgurore.** Familje e perbere prej tre personash ne mosh madhore. Kryefamiljari Robert Shella eshte i semur i shendetiti mendor

dhe trajtohet me PAK, nukeshte ne gjendje per te punuar. Eshte nevoja e ndertimitte catise se re, tavane dhe suvatime te pjeseshme.

23. **Z.Ismail Gjozi. Fshati Gorican, Nj Administrative Kutalli.** Familje e perbere prej kater personash, dy prej tyre ne mosh madhore. Jetonin ne kushte shume te veshtira ekonomike, te papune dhe ne pamundesiper tariparuar vetbshtepine. Ishte nevoja per cati, pllaka dhe riparime te pjeseshme. E  vetmja e ardhur e tyre ishte bujqesia.

24. **Z.Dritan Llupo. Fshati Banaj. NJ Administrative Poshnje.** Kjo familje wshtw e perbere nga 5 anwtarw, nga kryefamiljari, bashkeshortja si dhe tre femije, gjithsej kater persona ne moshw madhore.  . Banesae tyrer ishte e ndertuarmethemel guri dhe muratur guri, ishte nevoja e nji catije, tavane si dhe suvatime te pjeswshme.

25. **Z.Rakip Zeka, Fshati Hinge, Nj Administrative Poshnje**. Familje e perbere nga tre persona nemosh madhore, Z.Rakip, Bashkeshortja dhe djaliityre. Z.Rakip ishte i papune dhe te gjitha te ardhurat vinin nga punae tij ne bujqesi. Shtepiaishte methemele guri dhe murature guri, kishte devijimte njiprej mureve te shtepise e cila perbente rrezik. Kerkohet cati, tavane, suvatime te pjeseshme dhe pllaka.

26. **Z.Dritan Llupo, Fshati Banaj, Nj Administrative Poshnje.** Familje e perbere prej 5 personash, kater prej tyre ne mosh madhore. Kyrefamiljari Z.Drian, Bashkeshortja e tij dhe tre femijet. Shtepia ishte me themel dhe muratur guri, ishte nevoja per cati dhe tavane, suvatimete pjeseshme.

27. **Znj.Manushaqe Nasufi, fshati Cete, Nj Administrative Cukalat.** Zonja jetonte ne fshat shume te larget dhe ishte e papune. Bashkeshorti i saj kishte nderuar jete pak kohe me pare dhe zonja ishte e papune. Tw vetmete ardhura te saj ishin nga bujaqesia. Banesa e saj ishte me themel dhe muratur guri, Ishte nevoj per cati, tavani si dhe suvatime.

28. **Z.Fatmir Guraj, Nj Administrative Ure Vajgurore** . Familje e perbere nga tre persona ne mosh madhore, Z.Fatmir, Bashkeshortja dhe djali i tyre Z.RFatmir eshte i papune dhe te gjitha te ardhurat vinin nga puna e tyre ne bujqesi. Shtepia ishte me themele guri dhe murature guri. Ka plasaritje dhe carje te mureve

**Përgatiti** | **DREJTORI**
**Gerald Bolani**

Redina Malasi

Silva muhametanji
Antonis Hoxholli

**KRYETARI I BASHKISË**

**JULIANA MEMAJ**